



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 17.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NTP THESAR&ISEFERI" për aktivitetin: "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7641-521 nxjerr:

### VENDIM

Aprovohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NTP THESAR&ISEFERI" e datës 11.03.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7641-521, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 11.03.2021, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Pezullohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 11.03.2021 dhe aktiviteti kthehet në rivleresim;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "NTP THESAR&ISEFERI" me datë 11.03.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i shtegut për ecje dhe vrapim" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-7641-521

Autoriteti Kontraktues, me datë 17.03.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi se tenderuesi i rekomanduar për dhenje të kontratës nuk plotëson kërkesat teknike profesionale, respektivisht se nuk ka ofruar kontrata për realizimin e projekteve të ngjajshme është i paqëndrueshëm, pasi që nga lista dhe deshmite shihet se kjo kërkesë është plotësuar. Lidhur me pretendimin se ka paqartësi për kontratën Hapja e rrugëve të reja në zonat rurale ju sqarohet se ajo kontratë është e verifikuar dhe është kontratë që është realizuar me Komunen tone si Autoritet Kontraktues;

-Pretendimi lidhur me stafin profesional te tenderuesit te rekomanduar per kontrate eshte pjeserisht i bazuar,pasi qe i njeiti ka ofruar CV-te,kontratat dhe diplomat e stafit dhe lidhur me pretendimin se diplomat jane te nje shteti tjetër dhe duhet te nostrifikohen nga Ministria e Arsimit ju sqaroj se kjo nuk ka qene kerkese e Autoritetit Kontraktues dhe siqe e dini edhe ju vleresimi duhet te behet vetem sipas kerkesave ne dosjen e tenderit,por lidhur me diplomën per Inxhinier civil dhe inxhinjer konstruktiv ne e kemi trajtuar si kualifikim te njejte por me emertime te ndryshme ne varshmeri nga Institucioni dhe Shteti ku eshte marre kualifikimi,por edhe ky pretendim mbetet te sqarohet ne procesin e rivleresimit;

-Lidhur me pretendimin se tenderuesi i rekomanduar per kontrate nuk ka dorezuar deshmi per posedimin e paisjeve,poashtu nuk qendron pasi qe i njeiti ka ofruar deshmi per me shume paisje se sa qe jane kerkuar(kamion dhe eskavator),ndersa qendron pretendimi lidhur me deshmine per grejder pasi qe e njeita ka qene e pa lexueshme Autoriteti Kontraktues ka kerkuar deshmi fizike,e cila eshte ne dokumentacion dhe besoj e keni verejtur gjate çasjes tuaj.Pasi qe eshte veshtire te definohet a eshte deshmia e sjellur e njejte me ate te pa lexueshme nga oferta ,mbetet detyre e nje komisioni profesional ne fazen e rivleresimit qe ta sqaroj kete pretendim.

-Pretendimi se nga tenderuesi "Shkoza F07&Çlirimi 99 SHPK" nuk jane kerkuar sqarime eshte i bazuar dhe keto sqarime duhet te kerkohen ne fazen e rivleresimit.

Nga sqarimet paraprake konstatoj se vleresimi nuk eshte kryer ne teresi sipas dispozitave ligjore dhe kerkoj qe ne fazen e rivleresimit te behet nje ekzaminim profesional i te gjithë tendereve te pranuar duke trajtuar edhe pretendimet e bazuara nga ky Vendim.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Me kete Vendim duhet te njoftohet Drejtoria perkates dhe te kerkohen propozimet per anetar te komisionit per rivleresim.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

